



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN E
MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE

TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR:
KUALIFIKIMI PROFESIONAL “TEKNOLOGJI KIMIKE”

(Niveli IV në KSHK, referuar Niveli IV në KEK)

Tiranë, 2024

1. Udhëzime të përgjithshme

Ky program orientues ndihmon në përgatitjen e nxënësve për Kualifikimin Profesional “**Teknologji kimike**”, me strukturë 2+1+1, për provimin e detyruar “Teori profesionale e integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale. Ai synon orientimin e përgatitjes së nxënësve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndëve teorike profesionale. Njëherazi, ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të nxënësve sepse mundëson zhvillimin e testeve përmbledhëse. Programi orientues për provimin e “Teorisë profesionale të integruar” bazohet në:

- Programet e lëndëve teorike profesionale të Kualifikimit Profesional “Teknologji kimike”, Niveli II i KSHK-së (klasa e 10-të dhe klasa e 11-të).
- Programet e lëndëve teorike profesionale të Kualifikimit Profesional “Teknologji kimike”, Niveli IV i KSHK-së (klasa e 13-të).
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MFE nr. 27, datë 12.12.2023 “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2024”.

Në të përfshihen njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të këtyre programeve dhe që janë në themel të formimit teorik profesional të nxënësit.

2. Udhëzime për zbatimin e programit

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes sepse evidenton dhe përforcon njohuritë teorike, por dhe aftësitë e nxënësve për aplikimin e njohurive në situata të njohura e të reja, analizën dhe vlerësimin e këtyre situatave. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të “Teorisë profesionale të integruar”, nuk duhet të përfshijnë për vlerësim tema mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimin e detyruar të “Teorisë profesionale të integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste të nxënësve të tij, me teste që mund t’i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e mëparshme të testeve të Maturës Shtetërore për teorinë profesionale.

Testi për Kualifikimin Profesional “**Teknologji kimike**” do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel. Gjatë hartimit të njësive të testit duhet të mbahen parasysh synimet e përgjithshme, në skeletkurrikulat përkatëse, të temave të përzgjedhura në këtë program.

Nxënësit duhet të kenë parasysh se lënda, e cila ka peshën më të madhe në këtë program orientues të Maturës Shtetërore Profesionale, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

3. Lëndët dhe temat përkatëse

Në programin orientues të provimit të “Teorisë profesionale të integruar” në kuadrin e provimit të detyruar “Teori profesionale e integruar”, të Maturës Shtetërore Profesionale, për Kualifikimin Profesional “Teknologji kimike“, do të përfshihen programet e lëndëve profesionale të mëposhtme:

Tabela 1: Lëndët profesionale të përfshira në programin orientues dhe peshat e tyre përkatëse janë si më poshtë, duke konsideruar vëllimin dhe rëndësinë e tyre në formimin profesional të nxënësve.

Nr	Lëndët	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Sigurim teknik dhe mbrojtje mjedisi	34	14
2	Teknologji kimike	164	60
3	Procese dhe pajisje të teknologjisë kimike	41	15
4	Kontrolli teknik dhe fiziko-kimik në teknologjinë kimike	30	11
	TOTALI	269	100%

Temat sipas lëndëve janë:

a) “**Sigurim teknik dhe mbrojtje mjedisi**”, kl.10 dhe kl.11: **(34 orë)**

- Rregulla e sigurimit gjatë përdorimit të makinerive dhe pajisjeve të teknologjisë kimike 10 orë
- Dokumentacioni për sigurinë sipas vendit të punës 8 orë
- Koncepti dhe natyrat e ndotjes së mjedisit. Klasifikimi i ndotësve dhe burimet e ndotjes. 6 orë
- Minimizimi dhe reduktimi i mbetjeve në mjedis nga proceset e teknologjisë kimike, metodat e trajtimit dhe parandalimit të tyre 10 orë

b) **“Teknologji kimike”, kl.10 , kl.11 dhe kl.13: (164 orë)**

- Objekti i teknologjisë kimike. Roli dhe rëndësia e saj 2 orë
- Uji në industrinë e materialeve të ndërtimit 6 orë
- Teknologjia e prodhimit të qeramikës së ndërtimit 14 orë
- Teknologjia e prodhimit të qeramikës së hollë 10 orë
- Teknologjia e prodhimit të gëlqeres 8 orë
- Teknologjia e prodhimit të gipsit 8 orë
- Teknologjia e prodhimit të çimentos 14 orë
- Kuptimi për hidrokarburet dhe rëndësia e industrisë së hidrokarbureve 4 orë
- Përbërja e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre 6 orë
- Vetitë që lidhen me djegien e hidrokarbureve 6 orë
- Distilimi i naftës 10 orë
- Koksifikimi i mazutit 10 orë
- Prodhimi i hidrogjenit 8 orë
- Hidroastrimi i gjysmë produkteve të naftës 10 orë
- Pastrimi i gazit dhe prodhimi i sqfurit 10 orë
- Krekingu i naftës 10 orë
- Teknologjia e prodhimit të tullave të lehtësuara silikate (TLS) 8 orë
- Teknologjia e prodhimit të materialeve zjarrduruese 6 orë
- Teknologjia e prodhimit të bojërave dhe llaqeve 8 orë
- Mirëmbajta dhe shërbimet në teknologjinë kimike 6 orë

c) **“Procese dhe pajisje të teknologjisë kimike”, kl.10 dhe kl.11: (41 orë)**

- Madhësitë, përmasat. Sistemet e njërive të matjes. Simbolet që përdoren në teknologjinë kimike. 4 orë
- Rrjedhësit dhe regjimet rrjedhëse, gjendja e qëndrueshme dhe e paqëndrueshme 4orë
- Pompat ne industrinë kimike, parametrat, karakteristikat, llojet e tyre 5 orë
- Klasifikimi i materialeve të ngurta 2 orë
- Ndarja e sistemeve heterogjene 2 orë
- Centrifugimi, ndarja me dekantim, ndarja me filtrim, konstruksioni centrifugave, hidrociklonet 4 orë
- Absorbimi (aparartet e absorbimit: kolonat me pjata dhe kolonat me mbushje) 6 orë
- Adsorbimi (aparartet e adsorbimit) 4 orë
- Tharja. Shkëmbimi i nxehtësisë dhe i masës në procesin e tharjes. Llojet e proceseve

- | | |
|---|--------|
| të tharjes dhe tharësve. | 6 orë |
| • Ekstraktimi (kolonat e ekstraktimit) | 4 orë |
|
 | |
| d) ” Kontrolli teknik dhe fiziko-kimik në teknologjinë kimike”, kl. 13: (30 orë) | |
| • Njohuri të përgjithshme mbi metodat instrumentale të analizës | 4 orë |
| • Analizat e naftës bruto dhe të nënprodukteve të saj | 10 orë |
| • Analizat e treguesve fiziko-kimik dhe mineralogjike të lëndëve të para, ndihmëse të prodhimeve qeramike | 6 orë |
| • Analizat e treguesve fiziko-kimik dhe mineralogjike të lëndëve të para, ndihmese të prodhimeve të materialeve lidhëse | 6 orë |
| • Manualet e kontrollit teknik në industrinë kimike, përgatitja dhe plotësimi i dokumentacionit teknik | 4 orë |